

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KESHILLI BASHKIAK DROPULL**

Nr. Prot.

Jorgucat, me 27 /01/2022

**PROÇES-VERBAL**

**TAKIM MË DATË:27.01.2022**

**Tema:** Mbledhja e Këshillit Bashkiak Dropull,

Të muajit Janar 2022,ora 9:00.

Mbledhja Zhvillohet në sallën e mbledhjes të Këshillit,

Kryesuesi I mbledhjes nënkryetar i këshillit z.Dhimitër Koça,ora e hapjes të mbledhjes ora 09:00,

Kuorumi prej 11 këshilltarësh,pjesëmarrës në mbledhje Dhimitër Koça ,Jorgo Luleme,Vasiliqi Nika,Masksi Qendro,Kristo Varsami,Alketa Basho,Angjeliqi Praso,Kostandina Doku,Fotaq Zhonga,Luljeta Pirali,Elefteria Karanxha.

Mungesat Donika Bauci,Elena Dhima,Eljona Mano,Marjeta Xhumba,Anastas Iso,Vjoleta Ndrico,Zhaneta Dralo,Thodhori Dhima,Llaokrat Konomi.

Dhimitër Koça nënkryetar i këshillit miraton kuorumun dhe hedh në votë procesverbalin e muajit Dhjetor dhe rendin e dites.Votojnë 11 këshilltar pro, kundër s'ka

.Pjesëmarrës në mbledhje Kryetari i Bashkisë z.Dhimitër Toli nënkryetar z.Lulo dhe z.Dhefto.Drejtor znj.Thala Pulla dhe Arjan Tusha,Drejtori ujesjellesit z. Teli Qirko,juristi z.Erald Maksuti,z.Berti Kasi dhe znj.Ana Xhaferi nga projekti Bashki te Forta,

Nënkryetari i këshillit fillon me rendin e dites,

Projekt-Vendim " Për miratimin e përfituesve të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmes ekonomike ".

Përfitues për vitin 2022 janë 67 familje dhe individë me fond 189,420 përfitojnë dhe 3 familje,Figalia Guxo,Persefoni Simo dhe Vjoleta Bakiri,Hiqet nga lista Stavrua Cilako ,përfitojnë dhe Thanas Pulla,Natasha Mano,Stefan Kazaqi dhe Kostandina Ruci.

Hedhim në votë piken e parë të rendit të dites dhe meqë s'ka pyetje miratohet me votim 11 këshilltarë pro,

Pika 2 e rendit të ditesës :Projekt-/Vendim "Për miratimin e tarifës së ujit të pijshëm, të Bashkisë Dropull për vitin 2022 ".

Diskuton drejtore i ujesjellesit z.Teli Qirko,per rezultatet e arritura dhe per cmimet e shitjes se ujit te ardhurat nuk jane te kenaqeshme per shkak te situates te pandemise,ne vijme me propozimin per keshillin bashkiak per ndryshimin e tarifes te shitjes te ujit ,

Diskutuan keshilltaret Jorgo Luleme per cmimin e shitjes I cili propozon qe cmimi I shitjes te ujit te jete I njejte per gjithe banoret e Dropullit,dhe jo sipas projektvendimit te propozuar nga ujesjellesi,

Fjalën e merr dhe kryetari I Bashkise z.Dhimitraq Toli ,I cili flet per fondet qe kane ardhur per ujesellesat dhe propozon qe te shtyhet dhe per 2 apo 3 muaj per arsyen e vendosjes se sahatave ne 2 apo 3 fshatara qe te caktohet nje cmim konkret per shpenzimet e ujit,kemi probleme me fshatin Klishar ka 2,3 vjete qe nuk paguan uje ,dhe do te diskutohet serish me kryetarine fshatit ky problem.Do lajmerojme gjithe banoret per rritjen e cmimit te ujit .

Diskuton z.Thala Pulla per investimin e madh qe beri qeveria ne Dropull me ujesjellsat ,dhe sipas ligjit thote fondet te e dhena duhet te vilen Brenda 2,3 vjeteve,

Hedhim ne vote per tarifen e ujit nuk e votojne.

Nenkryetari thote :nuk miratohet projekt-vendimi nr.2

Pika 3 e rendit te dites Projekt-Vendim “ Per miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje per sezonin veror 01.06.2022 – 30.11.2022dhe per kullotat dimerore date 01.12.2022-31.05.2023 ,

Referon Lefter Nasto per kullotat e bashkise Dropull sipas listave bashkangjitur procesverbalit,

Nenkryetari I keshillit e kalon ne votim projekt vendimin dhe votohet nga 11 keshilltar pro,kundra ska.

Pra miratohet lista me kullota verore dhe dimerore,

Kalohet ne piken 4 te rendit te dites Projekt-Vendim “Per nje ndryshim ne vendimin nr.65,date 25.11.2021”per procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes se operatoreve per linjat e transportit rretqytetas te udhetareve ,si dhe rinovimin e licencave per keto linja”.

Fjalën e merr juristi I Bashkise,I cili thote jane te nevojeshme ndryshimet ne vendimin nr. 65 date 25/11/2021,per te percaktuar afatet dhe per menyren se si do te zhvillohet konkursi I hapur dhe te percaktohet sistemi i vleresimit te pikeve .

Nderhyn Nenkryetari I Keshillit,ka ndonje pyetje?

Pyetje nuk ka,kalohet ne votim projekt-vendim,votojne 11 keshilltare pro,kundra s’ka.

Pika 5 e rendit te dites: Projekt-vendim per raportin vjetor te vendimmarrjes dhe transparences te Keshillit Bashkiak.

Nenkryetari relaton Raportin,votojne 11 Keshillitar pro,kundra s’ka,miratohet projekt-vendimi.

Pika 6 e rendit te dites: Informacion nga komisioni I Barazise Gjinore per nivelin e barazise gjinore ne nivel lokal per te zgjedhurit apo emerimet ne administrate”.

Ne muajin Gusht-Shtator Bashkise I eshte kerkuar te plotesoj nje pyetesor qe mat niveline barazise Gjinore ne nivel Lokal,disa nga Drejtorite nuk I jane pergjigjur pyetesorit.

Keshtu qe performanca per barazine gjinore del e uletper aresye se nuk jane plotesuar pyetesoret.

-Per mbledhjen e muajit Shkurt :Raporti i monitorimit te zbatimit te buxhetit për vitin 2021.

-Raporti I vleresimit te te ardhurave 2023-2025.

Mbledhja Deklarohet e mbyllur .

Sekretar I Keshillit

Urania Kurumeno



Nenkryetar

Dhimitri Koça

